

**RELACION**  
**PËR**  
**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA DHE**  
**NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 81/2017 « PËR ZONAT E**  
**MBROJTURA »**

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË**  
**ARRIHEN**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 « Për zonat e mbrojtura » ka si qëllim rregullimin e disa problematikave që vijnë si pasojë e zbatimit të ligjit në terren kryesisht në bashkëpunimin e qeverisjes vendore, komuniteteve dhe administratës së zonave të mbrojtura. Gjithashtu Ligji aktual nuk zgjidh ngërce që ekzistojnë në realitet, si mbivendosja e ”Zonave me Përparësi Zhvillimi” me ”Zonat e Mbrojtura”. Kryesisht këto problematika janë të tilla për shkak të qasjes së hartimit të ligjit në vitin 2017 si një ligj strikt mbrojtës pa marrë parasysh faktorin e komunitetit që bashkëekziston në këto zona dhe në vitin 2023 kur zonat e mbrojtura përbëjnë 21.5% të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, pra më shumë se 1/5 e vendit, faktorët e anashkaluar në legjislacion bëhen évident dhe duhet të gjenden zgjidhje që adresohen pa kompromentuar parimet bazë të zonave të mbrojtura atë të ruajtjes dhe mbrojtjes së tyre. Qëllimi i këtij projektligji është gjithashtu evidentimi i parimeve dhe politikave të reja që duhet të zbatohen në zonat e mbrojtura si një evolim i këtyrë koncepteve të kryera nga organizmat ndërkombëtarë, rezultat i realiteteve të reja dhe i nevojës për një zhvillim të qëndrueshëm. Këto ndryshime vijnë në momente të një pjekurie intelektuale të shoqërisë dhe të vendosjes së rregullave të qarta dhe të përshtatshme për të siguruar që vendi ofron një paketë turistike të larmishme por edhe të

qëndrueshme dhe që komunitetet lokale u ofrohet një mundësi e shkëlqyer zhvillimi, duke krijuar vende pune, ekonomi dhe një perspektive rajonale. Ligji sjell koncepte të reja të kategorimizit të biodiversitetit në vend sipas rëndësië por edhe mundësinë e përditësimit të tij në mënyrë më të shpeshtë si dhe i jep një mundësi qeverisjes lokale dhe komuniteteve të jenë pjesë e kësaj vendimarrjeje. Qëllimi i ruajtjes dhe mbrojtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura nuk duhet të jetë përjashtues por gjithëpërfshirës duke prezantuar edhe edukimin përmes mjedisit. Nëpërmjet këtij projektligji synohet të adresohen të gjitha problematikat e shprehura nga përfaqësues të qeverisjes vendore në letrën e tyre drejtuar Kuvendit. Për arsyet më lart, lindi nevoja e propozimit të këtij projektligji.

## **II. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim hartohet në bazë të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, së Republikës së Shqipërisë.

## **III. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i propozuar parashikon disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 81/2017 Për Zonat E Mbrojtura, më konkretisht:

Në nenin 1 të projektligjit është parashikuar shtimi në nenin 4 të tre parimeve të rëndësishme si “parimi i përshtatshmërisë” “parimi i kategorizimit të objektivave” dhe “parimi i fleksibilitetit të menaxhimit”. Shtimi i këtyre parimeve lind si nevojë



për rritjen e efikasitetit në procesin e menaxhimit të këtyre zonave duke u bazuar në parimet e IUCN.

Në nenin 2 të projektligjit, është parashikuar shtimi i nenit 4/1 pas nenit 4 të ligjit bazë në kuadër të nevojës që ekziston për një bashkëpunim/ndërveprim me institucionet e tjera të qeverisjes qendrore, vendore si dhe shoqërinë civile me qëllim administrimin, ruajtjen dhe mbrojtjen efikase të këtyre zonave.

Në nenin 3 të projektligjit, është parashikuar shtimi i nenit 4/2 pas nenit 4 të ligjit bazë në kuadër të nevojës për të përforcuar rolin e institucioneve publike me anë të bashkërendimit dhe harmonizimin e punës së përbashkët me qëllim sigurimin e ruajtjes, mbrojtjes dhe administrimit të zonave të mbrojtura.

Neni 4 i projektligjit, është parashikuar shtimi i nenit 4/3 pas nenit 4 të ligjit bazë në kuadër të dhënies së mundësisë së publikut për të patur akses në këto zona përveç rasteve kur niveli i mbrojtjes e pengon. Po ashtu, dhe pronarët dhe poseduesit e zonave të mbrojtura, të cilët duhet të garantojnë ruajtjen e këtyre pronave dhe vlerave të tyre. Kjo vjen edhe si pasojë e mungesës së bashkëpunimit me institucionet e për këtë arsye ky nen është vlerësuar i nevojshëm për tu shtuar.

Në nenin 5 të projektligjit, është parashikuar ndryshimi i nenit 6 të ligjit bazë ku është shtuar dhe “zona të mbrojtura me interes lokal/bashkiak, për shkak se është vakum në ligj dhe parashikimi i tij mund të lehtësojë menaxhimin e këtyre zonave nga institucionet e qeverisjes vendore.

Neni 6 i projektligjit, parashikon ndryshimin e nenit 8 të ligjit bazë, ku në pikën 3 të tij shtohet pika 3/1 në kuadër të mundësisë të bashkive, të menaxhojnë një pjesë të zonave të mbrojtura të cilat janë pjesë e territoreve përkatëse që administrojnë.

Në nenin 7 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 9, të ligjit bazë, i cili parashikon objektivat e shpalljes së territoreve si zona të mbrojtura. Ky ndryshim

propozohet me qëllim mbrojtjen e këtyre zonave me anë të rritjes së ndërgjegjësimit, edukimit të publikut, nxitjen për kryerjen e aktiviteteve kërkimore-shkencore, nxitjen për kryerje të aktiviteteve rekreative dhe veprimtarive ekonomike në përputhje me parimin e efektivitetit por dhe objektivat e zonës së mbrojtur.

Në nenin 8 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i pikës 6, të nenit 10, të ligjit bazë, në disa elementë të tij si përputhja me terminologjinë e IUCN nga ku “plani kombëtar të rrjetit përfaqësues të këtyre zonave” zëvendësohet me “Planit Specifik të Zonave”.

-Shkronja “ç” përshtatet duke përforcuar rëndësinë e një raporti të vlerësimit në mjedis, ku përcaktohen veprimtaritë që janë kryer në këto zona të propozuara për tu shpallur që mund të kenë dëmtuar diversitetin e tyre biologjik.

-Po ashtu, shtojmë dhe shkronjën “f” pas shkronjës “ë” ku parashikohet propozimi për veprimtaritë e lejuara në bashkitë të cilat kanë ne administrimin e tyre dhe territore të cilat shpallen apo janë shpallur zona të mbrojtura. Kjo shtesë lind si nevojë e përfshirjes së bashkive dhe popullatës vëndase në procesin e menaxhimit të tyre.

Në nenin 9 të projektligjit, parashikohet shfuqizimi i nenit 13 të ligjit bazë.

Në nenin 10 të projektligjit parashikohet ndryshimi i nenit 16 të ligjit bazë, në të cilin, përcaktohen qartësisht aktivitetet e lejuara apo të ndaluara në zonën e mbrojtur “Park Kombëtar”. Në gërmën “c” të pikës “2” parashikohet të shtohet përjashtimi në rastet kur KKT, ministria përgjegjëse apo bashkitë përkatëse evidentojnë se investimi në një zonë të caktuar është i një niveli të rëndësisë kombëtare dhe ky investim, në të njëjtën kohë, respekton kriteret e mbrojtjes.

Propozohet shfuqizimi i shkronjës “d”. Më tej, parashikohet, të shtohen në pikën “3” dhe “4” dhënia e mundësisë së zhvillimit të veprimtarive ekonomike nga banorët e



zonës. Veprimtari të cilat janë në përputhje me kriteret e mbrojtjes si dhe marrin miratim paraprak në bashki. Kjo është një nevojë që lind si pasojë e mospërfshirjes së banorëve që banojnë në këto zona, të kenë akses e të përfitojnë prej tyre.

Në nenin 11 të projektligjit parashikohet ndryshimi i pikës 3 të nenit 17 të ligjit bazë, ku shtohet fjalia se “ në rastet kur monumenti i natyrës nuk është në zonë të banuar nuk aplikohet përcaktimi i zonës së saj buferike”.

Neni 12 i projektligjit, parashikon shtimin e pikes 2/1, pas pikës 2, të nenit 19 të ligjit bazë me qëllim përcaktimin e veprimtarive të parashikuara në nenin 33 të këtij ligji. Po ashtu, propozon shfuqimimin e gërmës “b” të pikës 3. Pika 4 riformulohet për lehtësi leximi dhe kuptueshmërie.

Në nenin 13 të projektligjit, parashikohet ndryshimi i nenit 20 të ligjit bazë. Nga ku, shkronja “c” e pikës “3” ndryshon duke lejuar përdorimin e tokes dhe kryerjen e aktiviteteve të cilat zbatojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm me fokus zhvillimin ekonomik të zonës. Po ashtu, pas shkronjës “dh” të pikës “3” shtohet pika “e” me qëllim lejimin e ndërhyrjeve të lejuara urbane, rekreacionit apo industriale brënda zonës por duke ruajtur karakterin e saj sipas parashikimeve të këtij ligji. Parashikohet të propozohet dhe pika 3/1 pas pikës 3 nga ku përcaktohen veprimtaritë që do të ushtrohen dhe në bazë të nenit 33 të ligjit bazë. Ky ndryshim propozohet me qëllim nxitjen e zhvillimit të këtyre zonave në bazë të parimit të efektivitetit, por duke respektuar kriteret e tyre të mbrojtjes bazuar në planet përkatëse të menaxhimit.

Në nenet 14/15/16/17 të projektligjit parashikohet ndryshimet në nenet 21/22/23/24 të ligjit bazë, ku në secilën prej tyre shtohet pika 2/1 e cila referon në nenin 33 të ligjit bazë. Ky referim kryhet në funksion të qartësisë së veprimtarive të cilat lejohen të ushtrohen në këto zona.

Neni 18 i projektligjit, parashikon shtimin e pikës “4” dhe “5” të nenit 33 të ligjit bazë, ku propozohet se AKZM-ja dhe pushteti lokal duhet të nxisin nisma apo veprimtari të cilat kanë efekte pozitive në zonat e mbrojtura. AKZM-ja dhe ADZM-të përkatëse propozohet të hartojnë rregullore të cilat duhet të shpallen në vende të dukshme për vizitorët. Këto janë ndryshime që vijnë si nevojë e zhvillimit dhe miremenaxhimit të zonave të mbrojtura në përputhje me parimin e fleksibilitetit të menaxhimit.

Në nenin 19 të projektligjit parashikohet shtimi i shkronjës “j” në pikën “5” të nenit 38 të ligjit bazë, ku propozohet dhënia e mundësisë AKZM-së të vlerësojë dhe propozojë ministrit përgjegjës për mjedisin, rishikimin e planit të menaxhimit apo vetë zonat e mbrojtura. AKZM duke qënë agjencia përgjegjëse për zonat e mbrojtura dhe duke qënë ajo në mbikqyrje të tyre, vlerësohet se është legjitime të marrë këto nisma duke u bazuar në parimin e përshtatshmërisë.

Neni 20 i projektligjit, parashikon ndryshimin e nenit 42 të ligjit bazë nga ku në shkronjën “f” të pikës “3” të tij shtohet dhe fjala “ekonomike” duke ju përshtatur qëllimit të këtij projektligji dhe nevojës që nevojitet për cngurtësimin e tij. Po ashtu, pas pikës “5” shtohet pika “6” e cila parashikon se AKZM-ja dhe ADMZ-të përkatëse kanë të drejtën të kërkojnë rishikimin e planit të menaxhimit sipas nevojës duke respektuar procedurat e parashikuara në ligjin bazë.

Në nenin 21 të projektligjit, parashikohet shtesa në nenin “74”, dispozitat kalimtare, dhe propozohet dhënia e një hapësire kohore prej 1 viti, Këshillit të Ministrave, Ministrisë dhe KKT për të reflektuar ndryshimet e kryera dhe në aktet nënligjore të lidhura me to.

Në nenin 22 të projektligjit, parashikohet hyrja në fuqi e tij.

#### **IV. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e ligjit janë:

- a- Ministria përgjegjëse për mjedisin;
- b- AKZM dhe ADZM-të;
- c- Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

#### **PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT**

Ky projektligj është hartuar nga deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.

**PROPOZUESIT**